



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 16, datë 06 . 12 .2023

“Për rinovimin e kontratës nr.7376, datë 12.11.2018 “për dhenien në përdorim të sipërfaqes prej 0.5 ha në parcelen nr .3b, ekonomia pyjore gjader mnelë për mbareshtimin e flores së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

Mbështetur në nenin 821, të Ligjit nr 7850, datë 29.07.1994 “ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e/l”, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, *i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës ____ . ____ 2023 të :

V E N D O S I

1.Miratimin e rinovimit të kontratës nr.7376, datë 12.11.2018 “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 0.5 ha në ngastren nr. 3b, Ekonomia Pyjore Gjadër Mnelë për mbarështimin e florës egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” .

2.Afati i rinovimit me qira të jetë deri në 9 (nëntë) vjet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 16, datë 06 . 12 .2023

“Për rinovimin e kontratës nr.7376, datë 12.11.2018 “për dhenien në përdorim të sipërfaqes prej 0.5 ha në parcelen nr .3b, ekonomia pyjore gjader mnelë për mbareshtimin e flores së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

Mbështetur në nenin 821, të Ligjit nr 7850, datë 29.07.1994 “ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e/l”, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, *i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës ____ . ____ 2023 të :

V E N D O S I

1.Miratimin e rinovimit të kontratës nr.7376, datë 12.11.2018 “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 0.5 ha në ngastren nr. 3b, Ekonomia Pyjore Gjadër Mnelë për mbarështimin e florës egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” .

2.Afati i rinovimit me qira të jetë deri në 9 (nëntë) vjet .

3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
G.JOVALIN ZEFI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 63 prot.

Vau Dejës, më 06.12.2023

RELACION

PËR RINOVIMIN E KONTRATËS NR. 7376 DATË 12.11.2018 “PËR DHËNJEN NË PËRDORIM TË SIPERFAQES PREJ 0.5 HA NË NGASTRËN NR 3/b,EKONOMIA PYJORE GJADËR MNELË PËR MBARËSHTIMIN E FLORËS SË EGËR DHE KULTIVIMIN E BIMËVE TË NDRYSHME”.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Të nderuar këshilltarë.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohen: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qira/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve ku kërkohet miratimi nga ana juaj i rinovimit të kontratës së qerasë për përdorimin e fondit pyjor për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme sipas kontratës se lidhur nga Bashkia Vau Dejës me nr. **7376 prot**,datë **12.11.2018**.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57 datë 30.4.2020 “Për Pyjet”,neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e(l) , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë,dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Ligji nr 7850 datë 29.07.1994 “Për kodin civil të Republikës se Shqiperisë “të ndryshuar neni 801,804 .

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” pika nr.2 germa a dhe pika 7.

Sipërfaqja që kërkohet rinovimi i kontratës është 0.5 ha.

Afati i rinovimit të kontratës do të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim dhe afatit të përcaktuar, sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim(me qira) të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”,shtojca **1**, pika **3/2**, vlerat **janë si më poshtë.**

| 3. Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme | | | | | |
|--|------------------------|-----------------------------|---|-----------|-----------|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Sipërfaqja e përdorur në Ha | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit | | |
| | | | 1 vit | 2- 5 vjet | 6-10 vjet |
| 2 | Pyll, shkurre | 0.5 | 23760 | 22770 | 19800 |

Vlera totale e pagesës/vit është 0.5 ha x 19,800 = 9,900 (Nëntë mijë, e nëntë qind) lekë në vit.

Sipas VKM nr 748 date 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës ,distancës dhe gjerësisë të brigjeve të burimeve ujore”,sipërfaqja që do jepet në përdorim ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5:Në liqene,rezervuarë,pellgje me ujë,natyrorë apo artificialë,laguna,zona dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujor.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e rinovimit të kontratës nr.7376 datë 12.11.2018 “Për dhënie në përdorim të sipërfaqes 0.5 ha në ngastren nr.3b, ekonomia pyjore gjadër Mnelë për mbarështimin e florës se eger dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.

Bashkëlidhur po ju dergojmë:

1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.

2.Kontratën e qirasë **nr. 7376 prot,datë 12.11.2018.**

3.Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.65 datë 22.08.2018.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punës

Ing.Mark Suli



Miratoi

Drejtori

Vehbi Shkjau



Ing.Zeqir Ujka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES

BASHKIA VAU DEJES
Nr. 7376 prot.

Vau Dejës, më 12.11.2018

Subjekti "Tomë Prenga"
Nr. 01 prot.

Vau Dejës, më 09.11.2018

KONTRATE QIRAJE

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR

Në zbatim të nenit 19 të ligjit Nr. 9385 datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar, nenit 17 të ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor të ndryshuar, nenit 801 e në vijim të ligjit Nr.7850. date 29.07.1994, "Per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve" dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 65 date 22.08.2018, "Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme subjektit "Tomë Prenga", të sipërfaqes nga prona fond Djerre , e ndodhur në njësinë Administrative qendër, Bashkia Vau Dejës", njoftimit të fituesit në APP, buletini nr.44, datë 05.11.2018, lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet palëve:

lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet palëve:

I. PALET :

Bashkia Vau Dejës, e përfaqësuar me autorizim nga zv. Kryetar **Z. Admir HASMEGAJ** që këtu e më poshtë do të quhet "**Qiradhënësi**":

dhe "**Tome Prenga**", regjistruar si person fizik me adresë: **Lagjia Kinoklub, Qyteti Vau Dejës,**

Shqipëri, me Nipt fermeri Nr. **L76708133P** përfaqësuar nga **Tomë Prenga**, këtu e më poshtë referuar do të quhet "**Qiramarësi**".

Se në sipër Palët bien dakort si më poshtë:



II. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate, Palët bien dakord si vijon:

1. Kushtet Paraprake dhe Shtojcat.

Kushtet Paraprake ashtu si dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të saj.

2. Përcaktime.

Sipërfaqe përdorimi: Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar. **Objekti :** “**Faqia e Çelikut**”, **Ekonomia Pyjore Gjadër Mnele, ngastra nr.3b, Bashkia Vau Dejës, Qarku shkodër “Për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”**

Rrugë Kalimi/E Drejta e Kalimit: Rruga është për përdorim publik .

Neni 1

Objekti i kontratës

1.1 Objekti i kësaj kontrate është, **dhënia me qira** subjektit “**Tomë Prenga**”, të **0.5 (ha)** (djerre) në pronësi të Bashkise Vau Dejës e përfshirë në ekomominë pyjore **Gjadë Mnele në ngastrën nr.3b** , për ushtrimin e veprimtarisë “**Për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**”, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Bashkise Vau Dejës **Nr. 65 date 22.08.2018**, me kufizimet dhe kordinatat sipas hartës pyjore ku është pasqyruar pozicioni i sipërfaqes pyjore ne harte , të dhënë në **Aneksin C**.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Kontratë ka për qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes të përcaktuar në Nenin 1 të kësaj kontrate për ushtrimin e veprimtarisë: “**Për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**” vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga **Këshilli i Bashkise** për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe proces verbalin e dorëzimit të zones/ sipërfaqes së marre në përdorim.

Neni 3

Afati i kontratës

Kontrata e Qirasë lidhet për një afat 5 (pese) vjecar, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Vlera e kontratës

Subjekti “Tomë Prenga”, Për përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme sipas Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “**Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve**”, lidhja 2, pika 2./4 vlera e përdorimit është:

- **Sipërfaqia prej 0.5 ha x 17 250 lekë/ha/vit = 8 625 Leke**



Njësia administrative Qendër, Bashkia Vau Dejës

- **Total Vlera e qeraseshite: 8 625** (tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) *lekë , nw vit.*

Neni 5

Pagesa dhe regjimi i saj

- 5.1 Pagesa e qirasë do të bëhet sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 5.2 Pagesa do të bëhet brënda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët.
- 5.3 Vlera e qerasë është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr. 391, datë 21.06.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave", të ndryshuar me V.K.M. 1064 datë 22.12.2010.
- 5.4 Qiraja do paguhet në llogarinë bankare me nr.Nipti **K567050070**, të Bashkise Vau Dejës,
- 5.5 Në rast se Qeramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa me sipër, Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes se kamatëvonesave do të konsiderohet data e përcaktuar ne piken 5.3 te kësaj kontrate.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

- 6.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundësinë që ta gëzojë dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
- 6.2 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 6.3 Qiradhënësi ka te drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
- 6.4 Qiradhënësi monitoron planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, dhe merr në dorëzim sipërfaqen e dhene me kontrate qiraje me merfundimin e saj dhe pas rehabilitimit.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

- 7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi " ka ta drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra paisje dhe materiale të tjera brënda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohëshme ose të përhershme, si dhe punime të tjera në përputhje me kërkesat e planit te rehabilitimit te sipërfaqes objekt perdorimi për ushtrimin e aktivitetit të saj.
- 7.2 Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.



- 7.3 Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nënkontraktme me subjekte të tjerë apo t'ja kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
- 7.4 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
- 7.5 Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
- 7.6 Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në perputhje me dispozitat e Ligjit 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.
- 7.7 Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Bashkisë të ushtrorin kontrollin për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhënë në përdorim.
- 7.8 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
- 7.9 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e nenëve 37 dhe 38 të ligjit 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

Neni 8

Detyrime të përbashkëta të palëve

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim në adresat e më poshme:

Për Qiradhënësin: Bashkia Vau Dejes

Për Qiramarrësin: “Tome Prenga”,

Lagjia Kinoklub, Qyteti Vau Dejës

Tel kontakti: 069 5745 602

Neni 9

Forca madhore

Në rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pëzullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

- 10.1 Kjo kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në nenin 3.
- 10.2 Kjo kontratë është automatikisht e pavlefshme, nëse nuk është nënshkruar pasi të jetë marrë miratimi nga (Këshilli i Bashkisë), sipas kërkesave të Nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar dhe nenit 19 të ligjit Nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, si dhe kur kontrata është e pashoqëruar me Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa



ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve" lidhjes nr 2 pika nr 2,/4 hartën pyjore të gjereferuar me poligonin e siperfaqes së marre në përdorim koordinatat përkatëse, proces verbalin e caktimit dorëzimit të zonës/siperfaqes së marre me qira ,hartuar nga struktura e Pyjeve në Bashki.

- 10.3 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj, vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të moskryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar.
- 10.4 Kjo kontratë zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur subjekti për siperfaqen që ka kryer veprimtarinë nuk e ka rehabilituar në zbatim të planit të rehabilitimit, në rast se një detyrim i tillë është parashikuar në miratimin e Këshillit të Bashkisë.
- 10.5 Nëse rezulton ndonjëri nga rastet e parashikuara në këte nen që përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, pala e dëmtuar i dërgon një njoftim me shkrim palës tjetër, duke i evituar shkeljen e kushteve të kontratës dhe lënien e një afati 7 ditor për plotësimin apo përmbushjen e kushteve kontraktore dhe se në rast të kundërt, pra në rast mospërmbushje pas kalimit të këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur. Ky njoftim ka vlerën e kushtit zgjidhës të kontratës pa qenë e nevojshme që zgjidhja të shpallet nga gjykata apo organ tjetër.

Neni 11

Dispozita të fundit

- 11.1 Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme në rast se do lindin mosmarrëveshje midis palëve, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.
- 11.2 Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder .
- 11.3 Çdo korigjim i kontratës, para dhe pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme. Kjo kontratë qiraje u formulua në tre kopje origjinale, bashkëlidhur së cilës janë plani i reabilitimit, *Urdhëri që ka miratuar lidhjen e kontrates, Nipti i subjektit prane ,projekt teknik ,hartën topografike me koordinatat e siperfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallen 1:10000 ku janë evidentuar elementët kryesore*, nga këto kopje një e merr Qiramarrësi, Dy Bashkia Vau Dejes .

QIRADHENESI
BASHKIA VAU DEJES
Me autorizim

ZV/KRYETARI
ADMIR HASMEGAJ



QIRAMARRESI

Tomë Prenga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISE**

V E N D I M

Nr. 65, datë 22.08.2018

Për

Miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për mbareshtimin e flores se eger dhe kultivimin e bimeve të ndryshme.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 22.08.2018, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, germa a dhe c ,nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, neni 55,pika 4 dhe 6 ,nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19 pikat 1’1/1 e ligjit nr. 9385 date 04.05.2005 “Për fondin pyjor“ i ndryshuar”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pikat 3,4 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Këshilli pas miratimit me shumice të cilësuar votash:

V E N D O S I:

Miratimin e ngastrës nr.3b sipas raportit teknik në një siperfaqe Djerre prej 0.5 ha në ekonomine pyjore Gjader Mnele për mbareshtimin e flores se eger dhe kultivimin e bimeve të ndryshme.

1. Afati i dhënies me qira do të jete 5(pese) vjet.
2. Vlera vjetore e dhënies me qira të jete sipas studimit teknik-ekonomik bashkëlidhur,sipas VKM nr.1064,date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Rural,Turizmit,Kulturës dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konfirmimim ligjor të Prefektit të Qarkut Shkodër.
5. U shpall sot me date 31 .08 2018

**SEKRETARI
Gentian NDOJ**



**KRYETARI
Martin MARKU**

HARTAT E OBJEKTIT

Shkalla:1.10 000

Ekonomia Pyjore Gjader Mnele SH 1:25 000

